



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

NJOFTIM PËR KONTRAKTIMIN E EKSPERTËVE TË JASHTËM

Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në nenet 25 dhe 40 të Ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-it (nr. 1, 10, 11, 12, 20, 21, 30, 40, 100, 200, 240, 300, 400, 1220, 1240, 1620, 3000-3100, 4000-4200, 5000, 5110, 5210, 5230, 5510, 5530 dhe 5600); si dhe Vendimin nr. 61, datë 09.05.2015 të Kryetarit të KLSH-së “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës së ekspertëve të përkohshëm të jashtëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit” (botuar në Fletoren Zyrtare nr.76/2015); për nevoja të punës shpall procedurat për kontraktimin e 2 (dy) ekspertëve të jashtëm për një periudhë 3 mujore.

Kërkesat për kandidatët ekspert i jashtëm:

-Të jenë diplomuar në ekonomik/financë;

-Të kenë eksperiencë mbi 10 vjet në KLSH(ish-auditues që kanë punuar në KLSH dhe janë në pension);

Përshkrimi i punës

Ekspertët e jashtëm të kontraktuar nga KLSH, do të angazhohen në:

Ekspertët e jashtëm të kontraktuar nga KLSH, do të angazhohen në:

- këshillimin e grupeve të auditimit apo strukturave të tjera organizative të KLSH-së, pjesë e procesit të shqyrtimit të dosjeve të auditimit, për çështje të ndryshme teknike që lidhen me auditimin;
- kryerjen e auditimeve të veçanta apo dhënien e një ekspertize të caktuar si pjesë e grupit të auditimit;
- dhënien e konsulencës profesionale mbi gjetjet apo konstatimet e grupeve të auditimit për drejtuesit dhe Kryetarin e KLSH-së;
- dhënien e një opinioni profesional lidhur me plotësinë dhe cilësinë e materialeve/ dokumentacionit të dosjes së auditimit, si procesverbale, aktverifikime, projektraporte, observacione, projektvendime, etj.;
- plotësimin e njohurive të grupeve të auditimit, në çdo fazë të zhvillimit të procesit të auditimit;
- kryerjen e analizave të riskut dhe çështje të tjera lidhur me menaxhimin e riskut si : identifikimi, vlerësimi dhe adresimi i riskut;
- marrjen pjesë në komisione të ndryshme në lidhje me zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe certifikimit të punonjësve të KLSH-së;
- hartimin apo dhënien e mendimit apo opinionëve për dokumente të ndryshëm si strategji, standarde auditimi, manuale, rregullore, ndryshime ligjore apo nënligjore si dhe propozimeve për ndryshime apo përmirësime legjislative apo rregullatore që i dërgohen institucioneve të ndryshme shtetërore;
- dhënien e një opinioni paraprak në lidhje me raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit;
- kryerjen e studimeve, analizave, artikujve, punimeve shkencore që i shërbejnë KLSH-së;
- në çdo veprimtari apo proces tjetër të konsideruar si të nevojshëm nga ana e Kryetarit të KLSH-së që shërben për të rritur impaktin, përfitimet dhe dobishmërinë e qytetarëve, shoqërisë dhe grupeve të interesit nga veprimtaria audituese .

Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në KLSH, deri më datë 12.09.2019 dosjen e tyre personale, e cila duhet të përmbajë këto dokumente:

- Curriculum Vitae;
- Kopje të diplomës së shkollës së lartë, të kualifikimeve pasuniversitare dhe gradave shkencore;
- Kopje të librezës së punës;
- Dokumente të tjera (nëse ka), që çmohen se shërbejnë në vlerësim e tij/saj.

Konkurrimi

Procedurat e konkurrimit dhe shpalljes së fituesve, do të bazohen në përcaktimet e bëra në Vendimin nr. 61, datë 09.05.2015 të Kryetarit të KLSH-së “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës së ekspertëve të përkohshëm të jashtëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76/2015).

Kontrolli i Lartë i Shtetit